

Ecuria e Procesit të Emërimit të Gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme (GJP): Roli i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) në emërimin e tyre të përkohshëm dhe të përhershëm

- *Ende në proces emërimi i përkohshëm i gjyqtarëve të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme*

Megjithëse Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) vendosi në mbledhjen e datës 27 dhjetor 2018 nisjen e procedurave për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve pranë Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ky proces nuk ka përfunduar ende.

Gjyqtarëve aktualë të Gjykatave të Krimeve të Rënda iu është siguruar vijimësia në detyrë duke iu garantuar kalimi në Gjykatat e Posaçme, me kusht që ata dhe familjarët e afërt të tyre të pranojnë të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake.

Sipas ligjit vetëm në rastin kur ndaj gjyqtarit në detyrë të Gjykatës së Krimeve të Rënda ka filluar procesi i rivlerësimit në shkallë të parë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), **dy javë** pas krijimit të tij e cakton atë përkohësisht në nivelin përkatës në Gjykatën e Posaçme.

Deri tani vetëm për dy gjyqtarë të Gjykatave të Krimeve të Rënda ka përfunduar procesi i vlerësimit në shkallë të parë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), njëri prej të cilëve është zgjedhur anëtar në KLGJ. Ndërkohë asnjë nga gjyqtarët e tjerë të Gjykatave të Krimeve të Rënda nuk i është nënshtruar ende rivlerësimit nga KPK, duke sjellë për pasojë që emërimi i përkohshëm i tyre të varet vetëm nga vendimi për kufizimin e privatësisë.

Emërimi i gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme duhet të përfundojë brenda 2 muajve nga krijimi i KLGJ-së, që do të thotë se ky proces duhet të ndodhë brenda muajit shkurt. Brenda këtij afati Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda duhet të emërojnë gjyqtarët dhe të fillojnë të ushtrorjnë kompetencat e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

- *KPK fillon procedurat e rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda*

Vendimi i konfirmimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) është i nevojshëm edhe për emërimin e përhershëm të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme.

Me qëllim fillimin e procedurave të rivlerësimit për këto subjekte, KPK në shortin më të fundit të hedhur në muajin **Janar 2019** ka përfshirë dhe renditur të 13 gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Nga kjo gjykatë deri tani vetëm njëri nga gjyqtarët ka kaluar procesin e rivlerësimit, ndërkohë që procedurat e rivlerësimit për kryetarin e kësaj gjykate kanë filluar më herët.

Edhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ndodhet në të njëjtën situatë pasi vetëm një gjyqtare është konfirmuar nga KPK, por në këtë rast procedurat e rivlerësimit për gjyqtarët e kësaj gjykate kanë filluar më herët si rezultat i shorteve të mëparshme.

Megjithatë, edhe pse për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda shorti për fillimin e procedurave të rivlerësimit është zhvilluar që në 15 Maj 2018, gjatë gjithë kësaj periudhe KPK nuk ka zhvilluar asnjë seancë dëgjimore për gjyqtarët e apelit.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda			Gjykata e Apelit për Krime të Rënda		
	Emri/Mbiemri		Emri/Mbiemri		
1.	Ardit Mustafaj	Shorti i KPK 15 Janar 2019	1.	Fehmi Petku	Shorti i KPK 15 Maj 2018
2.	Irena Gjoka (Maneku)		2.	Gjovalin Pernoca	
3.	Etleva Deda		3.	Dhurata Haveri	
4.	Luan Hasneziri		4.	Nure Dreni	
5.	Flora Hajredinaj		5.	Saida Dollani	
6.	Fran Prendi		6.	Dhimitër Lara	
7.	Ilirjana Olldashi		7.	Sokol Binaj	
8.	Liljana Baku		8.	Amarildo Laçi	
9.	Marsela Balili		9.	Gurali Brahimllari	
10.	Bib Ndreca		10.	Idriz Mulkurti	
11.	Daniela Shirka		11.	Albana Boksi	
12.	Miliana Muça				
13.	Klodian Kurushi				

* Lista e gjyqtarëve të renditur në tabelë i referohet shortit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), të datës 15 Janar 2019 dhe shortit të datës 15 Maj 2018.¹

¹ <http://kpk.al/shorti/>

Me hedhjen e shortit të muajit janar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka filluar procedurat e rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë dhe Apelit, të cilët janë edhe kandidatët kryesorë për Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Ecuria e Ngritjes së Prokurorisë së Posaçme (PP): Numri i aplikimeve për prokurorë të posaçëm dhe përgjegjësia e KLP-së për fillimin e vlerësimit të aftësive profesionale të prokurorëve

- *Dy prokurorë aplikantë për Prokurorinë e Posaçme në më pak se dy javë nga shpallja e thirrjes për aplikime*

Prokuroria e Posaçme një nga institucionet më të rëndësishme të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), do të përbëhet nga 15 prokurorë. Ky numër u përcaktua nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) në seancën plenare të datës 7 Janar 2019.

Me qëllimin fillimin e përzgjedhjes së prokurorëve të posaçëm, KLP shpalli po në datë 7 Janar 2019 thirrjen për aplikime të kandidatëve për 15 vendet vakante prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, brenda një afati kohor jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e shpalljes së njoftimit.

Megjithëse mbeten më pak se dy javë deri në përfundimin e afatit të aplikimit për kandidatë për Prokuror të posaçëm kanë aplikuar vetëm 2 prokurorë aktualë të Prokurorisë së Krimeve të Rënda: Besnik Muçi, i cili është konfirmuar nga KPK dhe Klodian Braho.

Deri në datën 7 Shkurt 2019 mbetet ende kohë për të aplikuar, por numri i ulët i deritanishëm i aplikimeve përbën një sinjal jo pozitiv për ecurinë e ngritjes së SPAK. Prokuroria e Posaçme nuk mund të përbëhet nga më pak se 10 prokurorë, numër ky i nevojshëm për zgjedhjen e drejtuesit të këtij institucioni dhe vijimin e ngritjes së Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe kapaciteteve administrative të SPAK. Në rastin kur më pak se 10 prokurorë do të plotësojnë kushtet përfshirë vetting-un për tu emëruar prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, KLP e konsideron këtë një çështje për diskutim dhe për të cilën do të marrë një vendim bazuar në rezultatet e procesit të aplikimit.²

- *Këshilli i Lartë i Prokurorisë thirrje për të aplikuar në PP dhe masa paraprake për të siguruar ecurinë normale të procesit të ngritjes së SPAK*

Në funksion të menaxhimit të proceseve ligjore për ngritjen e Prokurorisë së Posaçme dhe SPAK, si dhe atyre të lidhura me strukturën dhe buxhetin e institucionit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka marrë një sërë masash paraprake për ti paraprirë ecurisë normale të ngritjes së organeve kryesore kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Në mbledhjen e fundit të zhvilluar në 21 Janar 2019, KLP ka miratuar një sërë masash ndër të cilat përfshihen:

² Kreu i KLP: SPAK nis punën edhe me “mungesa”. https://www.youtube.com/watch?v=M1tHz_XAQvk

- *Lehtësimit i dokumentacionit të kërkuar për aplikimin në Prokurorinë e Posaçme; KLP ka konsideruar të panevojshëm disa dokumenta të përfshira në thirrjen për aplikim përmes një email-i dërguar të gjithë prokurorëve;*
- *Miratimi i buxhetit dhe strukturës së KLP-së në përputhje me ngarkesën dhe ushtrimin e plotë të kompetencave; (miratimi i strukturës së KLP, e cila përfshin një një strukturë shtesë ndihmëse me 6 prokurorë);*
- *Marrja e masave për kalimin tranzitor nga Prokuroria e Përgjithshme të kompetencës së KLP-së lidhur me vlerësimin e performancës së prokurorëve dhe realizimin me cilësi dhe në kohë të kësaj përgjegjësie (projekt-vendim për plotësimin e burimeve njerëzore dhe teknike);*
- *Nevoja për të bërë prezente tek KPK rivlerësimin me përparësi të kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme.*

Për shkak të riorganizimit të plotë që pësojnë institucionet e hetimit, ndryshe nga emërimi i gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme, për emërimin e prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme është përcaktues konfirmimi paraprak nga KPK. Për këtë arsye, si rezultat i përfundimit të afatit të aplikimit në 7 shkurt 2019 dhe kërkesës ligjore për emërimin e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme po brenda muajit shkurt (dy muaj nga krijimi i KLP-së), koha e përfundimit të rivlerësimit nga KPK mund të konsiderohet tejet e sforcuar.

Megjithëse procedurat e rivlerësimit për prokurorët në të dyja Prokuroritë e Krimeve të Rënda (Shkalla e Parë dhe e Apelit) kanë filluar, duke iu referuar shorteve të datave 12.12.2017; 15.1.2018 dhe 17.09.2018, vetëm 5 prej tyre kanë kaluar gjykimin në shkallën e parë në KPK, prej të cilëve 4 janë konfirmuar. Nga prokurorët e konfirmuar 2 janë zgjedhur anëtarë të KLP-së dhe vetëm 1 prej tyre ka shprehur interes duke aplikuar në Prokurorinë e Posaçme.

Ende një numër i madh i prokurorëve të krimeve të rënda, ndër kandidatët më të mundshëm për SPAK do të duhet ti nënshtrohen procesit të rivlerësimit. Nevoja për të prioritarizuar rivlerësimin e tyre mbetet tejet imediate, duke patur në konsideratë që ky proces është kushti kryesor për emërimin e tyre në Prokurorinë e Posaçme.

Aktorët ndërkombëtarë pritshmëri për ngritjen e SPAK: EURALIUS, USAID dhe OPDAT mbështetje teknike në zbatimin e reformës

Procesi aktual i aplikimit të prokurorëve për Prokurorinë e Posaçme dhe ngritja e Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kanë qenë në vëmendjen e institucioneve ndërkombëtare pasi reforma në drejtësi dhe arritja e rezultateve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë ndër prioritetet kyçe për hapjen e negociatave me BE. Zyra e Delegacionit European në Tiranë dhe Ambasadori Luigi Soreca kanë nxitur prokurorët për të aplikuar për vendet vakante në Prokurorinë e Posaçme.

Në të njëjtën kohë, kur pritet të avancojë edhe procesi i ndërtimit të kapaciteteve të Gjykatave të Posaçme dhe SPAK, del në pah nevoja e koordinimit të një sërë aspektesh teknike, logjistike dhe ligjore të procesit.

Administrimi i këtyre aspekteve është i një rëndësie të veçantë duke patur parasysh faktin që të gjitha institucionet e drejtësisë në vend i janë nënshtruar një reforme gjithëpërfshirëse dhe të ndërlidhur në ushtrimin e kompetencave.

Një nga komponentët kryesorë të këtij procesi i referohet hartimit dhe konsultimit të akteve nënligjore të reformës në drejtësi, proces i cili është zhvilluar me asistencën e aktorëve më të rëndësishëm ndërkombëtarë si EURALISU, USAID dhe OPDAT.

Ministria e Drejtësisë ka hartuar dhe konsultuar me aktorë shtetërorë dhe të shoqërisë civile 8 akte nënligjore në zbatim të ligjeve të reformës në drejtësi. Ky proces ka synuar ndër të tjera të ndihmojë edhe Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë në aktivitetin tranzitor të punës së tyre.